



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 127, datë 28.07.2021

**PËR
MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 195,
DATË 29.12.2020 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË KOMISIONERE,
REGJISTRIMIN E DEGËS SË SHOQËRISË SË HUAJ KOMISIONERE DHE
NJOHJEN E SHOQËRISË SË HUAJ KOMISIONERE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 7, pika 1/a, të Ligjit “Për Tregjet e Kapitalit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020 “Për Licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve dhe Drejtoria e Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi .**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Në Rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020 “Për Licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

5. *“Shërbim investimi online” është ofrimi i shërbimit të investimit në distancë nga shoqëria komisionere/banka nëpërmjet një rrjeti elektronik komunikimi.*

Pika 5, e nenit 3, bëhet pika 6.

2. Shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

Neni 9/1

Dokumentacioni shtesë për ofrimin e shërbimeve të investimit online

1. Shoqëria komisionere që kërkon të ofrojë shërbime investimi online, shoqëron njoftimin në Autoritet me dokumentacionin si më poshtë:

a) Vendim i organit drejtues të shoqërisë për ofrimin e shërbimeve online;

b) Përshkrim i detajuar i modelit të biznesit që do zhvillojë shoqëria;

c) Marrëveshje e nënshkruar me shoqërinë që ofron sistemin/programin kompjuterik për realizimin e shërbimit;

d) Evidencë për efektivitetin dhe sigurinë e sistemit;

e) Dokument që vërteton njohuritë dhe eksperiencën e personelit kyç në shërbimet e investimit online;

f) Procedurë e funksionimit të shërbimit të investimit online, përfshirë mekanizmat e sistemit të kontrollit të brendshëm,

g) Procedurë e klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve online;

h) Procedurë e ruajtjes dhe administrimit të aseteve të klientit të rezultuara nga shërbimi online;

i) Kontratë-tip me klientin.

2. Kërkesat e këtij neni janë të zbatueshme edhe për bankat.

3. Në nenin 17, pika 1, shtohet germa (e) me këtë përmbajtje:

e) Ofrimin e shërbimeve të investimit online.

4. Në nenin 23, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

2/1. Në rastin e ofrimit të shërbimit të investimit online nga shoqëria komisionere/banka, Autoriteti pas vlerësimit të dokumentacionit sipas nenit 9/1 të kësaj rregulloreje, i jep shoqërisë komisionere/bankës të drejtën për kryerjen e shërbimeve të investimit online.